



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 60, datë 09/12/2004

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.39,
DT.30/07/2004 “ PËR DHËNIE STIMULI NXËNËSVE ME REZULTATE TË
SHKËLQYERA NË SHKOLLAT PUBLIKE TË QYTETIT TË TIRANËS”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, për financimin e projektit “Dhënie stimuli nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të qytetit të Tiranës”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 11, pika 3/a, neni 72, pika 1/c, neni 10, pika 3 (paragrafi II/c) dhe neni 32/m, ligjin Nr.7776, dt. 22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, në ligjin Nr.7952, dt.21/06/1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 2, në Dispozitat Normative “Për sistemin parauniversitar” të vitit 2002, neni 28, neni 29, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të viti 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, mbështetur në kërkesën e një grupi nxënësish të qytetit të Tiranës dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I;

1. Në pikën 1 të Vendimit Nr.39, dt.30/07/2004 pas fjalisë “... në shkollat e mesme të përgjithshme publike” të shtohet kjo përmbajtje “dhe nxënësit banorë të Tiranës të viteve të I, II, III, IV dhe V të shkollave të mesme profesionale publike”.
2. Efektet financiare për këtë kategori nxënësish fillojnë në Janar 2005.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Tiranës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI